



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 879/7 Prot

Tiranë, më 13.12.2021

Nr. 879 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbardimit Privat "3H" SHPK, në referim të **Urdherit të Ekzekutimit Nr. 929 prot date 31.12.2020 "i Gjykates Administrative të Shkalles së Parë Durrës**, kam vënë në ekzekutim këtë *urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr.879 kërkesën e **Kreditorit- Dega e Doganes Durrës** për vënie në ekzekutim të **titullit ekzekutiv**, Vendimi për rikuperim me force të borxhit doganor Nr. 170 prot date 28.10.2021i Deges Doganore Durrës, për **Debitorin – "Byllis Energji" shpk me NIPT L71710028I dhe administrator Arian Grubi**.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori—"Byllis Energji" shpk me NIPT L71710028I dhe administrator Arian Grubi, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit: – "**Byllis Energji" shpk me NIPT L71710028I dhe administrator Arian Grubi**, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.


Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Per Sherbimin Permbardimor Gjyqesor Privat",

Adresa: Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopça, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj_3h@yahoo.com



URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:
 - **Subjekti:** – “Byllis Energji” shpk me NIPT L71710028I dhe administrator Arian Grubi
2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “3 H” SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI



Adresa: Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopça, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj_3h@yahoo.com